

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA KOMBETARE E PRIVATIZIMIT

AKT-MAREVESHJE


Mbeshtetur ne VKM Nr. 405, date 31.08.1999 dhe Udhezimit Nr. 3, date 01.10.1999 te MEPP dhe AKP, midis Agjencise Kombetare te Privatizimit, perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem, Z. Qirjako Theodhori dhe Z. Klodo Blacollari lidhet sot me date 12.10.1999 per kushtet e privatizimit me ankand pa çmim fillestar te paketes prej 51% te aksioneve te Sh.A. "Auteksport import".

Pjesemarresi ne ankand bie dakord me kushtet e meposhtme:

1. Te respektoje rregullat e zhvillimit te ankandit sipas Rregullores se zhvillimit te tij dhe Udhezimit Nr. 3, date 01.10.1999, te cilat lexohen paraprakisht.
2. Ne rastin kur eshte fitues i ankandit, te paguaje brenda 30 diteve nga dita e marrjes se autorizimit vleften e plote te rezultuar nga ankandi. Ne rast te kundert vlefta e parapaguar prej 30% nuk i kthehet nga ana e AKP-se.
3. Pavaresisht nga çmimi i ankandit, pjesemarrja e bleresit ne kapitalin e shoqerise do te jete ne masen e perqindjes se paketes qe privatizohet.

PERFAQESUESI I AKP

Qirjako Theodhori
Drejtor i Pergjithshem




PJESEMARRESI NE ANKAND

Per "ZK GROUP"
Administrata
Klodo Blacollari



REPUBLIKA SHQIPERISE
DHE AGJENCIA KOMBETARE E PRIVATIZIMIT
Nr. 596 / 01.10.1999
Vartesisht...
njetë me...
u...
Nr. Passo



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA KOMBETARE E PRIVATIZIMIT
Nr. _____ Prot.

Tirane, 12 10 1999

**L E N D A : Autorizim per transferimin e paketes shteterore te aksioneve prej
51 % te Sh.A. "Arteksportimport" Tirane**

SH.A. "ARTEKSPORTIMPORT" TIRANE

MINISTRISE SE EKONOMISE PUBLIKE E PRIVATIZIMIT

MINISTRISE SE BASHKEPUNIMIT EKONOMIK DHE TREGTISE



Sh.P.K. "2K GROUP"

TIRANE

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 8334, dt. 23.04.1998, VKM Nr. 446, dt. 09.07.1998, VKM Nr. 405, dt. 31.08.1999, urdherit te Ministrit te Ekonomise Publike e Privatizimit Nr. 323, date 7.9.1999, te proces-verbalit te mbajtur gjate zhvillimit te ankandit dhe te raportit perfundimtar te tij, Agjencia Kombetare e Privatizimit

AUTORIZON

**Transferimin e paketes shteterore te aksioneve prej 51% te Sh.A.
"ARTEKSPORTIMPORT" Tirane ne favor te Sh.P.K. "2K GROUP".**

Çmimi i vendosur nga ankandi eshte 40.200.000 (dyzetmilion e dyqindmije) leke. Shpk "2K Group" ka bere paraprakisht pagesen prej 12.060.000 (dymbedhjetemilione gjashtedhjetë mije) leke me dokumentin bankar garanci bankare leshuar nga Tirana Bank me dt. 12.10.1999, me nr. Ref. 0288/12.10.1999.

Vlefte e paketes se aksioneve do te paguhet me para ne dore. Derdhja e parave do te kryhet prane Bankes se Kursimeve, Dega e Thesarit Tirane ne llogarine 4302 ku te cilesohet destinacioni i derdhjes.

Ky transferim aksionesh behet me keto kushte:

1. Pavaresisht nga çmimi i vendosur ne ankand, pjesemarrja ne kapitalin e shoqerise eshte

2. Paguesa e vlefes se plote te rezultuar nga ankandi te behet brenda 30 diteve nga data e leshimit te ketij autorizim, pra brenda dates 11.11.1999.

Mosploresimi i ketyre detyrimeve ne afatet e percaktuara ne kete autorizim ngarkon me pergjegjesi fituesin e ankandit SHPK "2K GROUP" dhe behet shkak per pavlefshmeri ketij autorizimi.

Ne rast se pagesa e plote nuk kryhet brenda afatit te percaktuar ne kete autorizim mbahet pagesa paraprake prej 30% e kryer nga SHPK "2K GROUP".

Qirjako Theodorori

Drejtor i Pergjithshem

REPUBLIKA E SHQIPRISE
DHOMIA E NOTERISE

Nr. Res. 2884 D.

VERIFIKIM

Z. J. Fama, me Nr. Pasaporte
Paradati Dokumentin Origjinalin dhe Varetet
që Fotokopja është një me Originalin /

Noter e
AFERDITA HAXHIA
TIRANE





REPUBLIKA E SHQIPERISE

Ministria e Ekonomise Publike
dhe Privatizimit



Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Mesme e te Vogla

URDHER

Nr. 323 Date 7-4 1999

PER

PRIVATIZIMIN ME ANKAND PA CMIM FILLESTAR TE PAKETES SE AKSIONEVE SHTETERORE TE SHOQERISE ANONIME "ARTEKSPORTIMPORTI "TIRANE

Ne baze nenit 2 te Ligjit Nr.8237 date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926 date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" ndryshuar me akte te tjera ligjore, me cilesine e aksionerit te vetem , ne mbeshtetje te Ligjit Nr 8334 date 23.4.1998 " Per privatizimin e shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjik , V.K.M. Nr. 446 date 9.7.1998 "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shteterore te aksioneve te shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjik, VKM Nr. 684 date 28.18.1998 "Per nje shtese dhe ndryshim ne VKM Nr. 446 date 9.7.1998 "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shteterore te aksioneve te shoqerive tregtare, qe veprojne ne sektoret jo strategjike, VKM Nr 405 date 31.8.1999 "Per procedurat e privatizimit me ankand pa cmim fillestar te paketave shteterore te aksioneve te disa shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jostrategjik, VKM Nr 407 date 31.8.1999 "Per privatizimin me ankand pa cmim fillestar te paketave shteterore te aksioneve te disa shoqerive tregtare"

Urdheroj:

1-Te privatizohet me ankand, pa cmim fillestar paketa shteterore e aksioneve te "Arteksportimporti " Sh.A Tirane , sipas V.K.M. nr 405 date 31.8.1999 , dhe V.K.M.nr 407 date 31.8.1999.

2-Transferimi i paketes shtetërore të aksioneve në masën 51 %, përcaktuar sipas V.K.M. Nr. 684 datë 28.10.1998.

3-Dokumentacioni i depozituar në Agjensinë Kombëtare të Privatizimit me shkresat nr 3621/2 datë 29.7.1999 sipas V.K.M nr 446 datë 9.7.1998 të shërbeje për fillimin e procedurave të privatizimit.

4-Transferimi i aksioneve në përputhje me pikën 2 të këtij urdhëri të përfundojë brenda afatëve ligjore në fuqi

5- Urdhëri nr. 40 datë 29.7.1999 anulohet.


*Notare
Bianca Ruzhici*



REPUBLICA SHQIPËRI
DHOMA E NOTERËVE TIRËNË
Nr. 696 Rep. Dt: 16.12.98
VERËTET
Vërtetohet se fjalorët e listës së
nënkombësive të shtetit të
Juni 1998
N° P1540 *J. Krasniqi*

MINISTR

Ylli BU





REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE _____
NOTER _____

Nr. _____ Regj. Nr. _____ Kol.

N^e Protokolli - 3393

Tirane, _____ 1999

KONTRATE

PER SHITJEN (TRANSFERIMIN) E PAKETES SHTETERORE PREJ 51% (PESEDHJETE E NJE PERQIND) TE "ARTEKSPORTIMPORT" SH.A. TIRANE

Sot, me date 12.11.1999 (njemije e nenteqind e nentehjete e nente), ditën e premte, në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit Tirane, përpara meje noterese të Dhomes së Noterise Tirane, Z. Aferdita HAXHIA, hartohet kontrata e shitjes së paketës së aksioneve prej 51% e barabartë me 48.297 aksione në "Arteksportimport" Sh.A. Tirane të regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tirane me Vendimin Nr.21370 Akt. date 24.05.1999,

midis paleve të cilat rane dakord si më poshtë :

Neni 1 - Palet

1.1 *Pala shitese:* Agjencia Kombëtare e Privatizimit Tirane e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i saj, Z. Qirjako Theodhori.

1.2 *Pala blerese:* "2K Group" Sh.p.k. i njohur si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tirane Nr.19653 Prot., date 22.06.1998, përfaqësuar nga Z. Koço Kokedhima i biri i Theodhoriut dhe i Efijeni i lindur në Qeparo Vlore me 21.04.1959 me numer pasaporte 0183354 madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar me adresë banimi : Rruga "5 Maji" Tirane. i shpallur fitues në ankandit të zhvilluar date 12 Tetor 1999 në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, i njohur me autorizimin Nr.2884, date 12.10.1999." për kryerjen e pagës së vlefës së plote të paketës shtetërore të aksioneve prej 51 % të "Arteksportimport" Sh.a., Tirane.

Neni 2 - Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontrate është shitja (transferimi) e 51% të aksioneve e barabartë me 48.297 aksione të zotëruara nga Shteti Shqiptar, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë Publike e Privatizimit, në "Arteksportimport" SH.A. Tirane, me vlerë 40.200.000 leke (dyzet milion e dyqind mijë).

Kapitali themeltar i shoqerise ne momentin e regjistrimit ne Gjykatën e Rrethit Tirane me vendimin Nr.21370 date 24.05.1999, te pasqyruar edhe ne Akt themelimit dhe Statutin e shoqerise rezulton me vlere 94.700.000 leke (nentedhjete e kater miljon e shtateqind mije) me 94.700 aksione me vlere nominale te nje aksioni 1000 leke, kapital sipas vleresimit me dokumentin bilanci reformuar i bazuar mbi bilancin ushtrimor te vitit 1997 i specifikuar : a) shuma e ndertesave me vlere 55.193990 leke dhe b) vlera e truallit sipërfaqe 4877.93 m2 sipas genplaneve dhe akt-vleresimeve qe shoqerojne keto genplane me vlere 3.520.653 leke.

Neni 3 - Çmimi i shitjes.

- 3.1. Çmimi i shitjes se paketes se aksioneve prej 51% te zoteruar nga shteti ne shoqerine "Arteksportimport" SH.A. Tirane eshte 40.200.000 leke (dyzet miljon e dyqind mije), vlere e realizuar ne ankandin e dates 12.10.1999 ne Agjencine Kombetare te Privatizimit dhe paguar plotesisht nga pala blerese ne Banken e Kursimeve, Dega Tirane, numri i llogarise 4302 (Dega e Thesarit) ne favor te Agjensise Kombetare te Privatizimit.
- 3.2. Pala shitesese deklaron se ne favor te saj eshte derdhur e gjithë shuma e percaktuar ne piken 3.1 te ketij neni para perpilimit te kesaj kontrate bazuar ne dokumentin bankar Local SwiftAcks-2094-000030 date 4 Nentor 1999 leshuar nga Banka e Tiranes Sh.a., sipas urdherxhimit te jashtem leshuar nga Banka e Kursimeve me numer 595891 date 04.11.1999 per 40.198.000 leke (dyzet miljon e njeqind e memte dhjete e tete mije), dhe nr.mandat arketimit te jashtem nr. 0918170 date 12.11.1999 per 2000 leke (dymije). Vlefte totale e paguar nga pala blerese eshte 40.200.000 leke (dyzet miljon e dyqind mije).

Neni 4 - Kushtet e shitjes

- 4.1. Pala blerese gjykohet se ka njohuri te plota per paketen e 51 % te aksioneve qe i eshte ofruar per blerje , me oferten e dhene nga ajo.
- 4.2. Pala blerese ka plotesuar te gjitha kushtet e percaktuara nga pala shitesese ne autorizimin Nr.3076 prot, date 25.10.1999(njemije e neneteqind e netedhjete e nente) te Agjensise Kombetare te Privatizimit Tirane.
- 4.3. Pala blerese pas nenshkrimimit te kesaj kontrate, noterimit te saj behet pergjegjese per te gjitha detyrimet ligjore ndaj shtetit qe mund te lindin ne lidhje me regjistrimin e kesaj pasurie qe nga momenti i firmosjes se kesaj kontrate.
- 4.4. Pas firmosjes se kesaj kontrate dhe noterimit te saj, pronesia e prej 51 % e aksioneve e barabarte me 48.297 aksione te Sh.A. "Arteksportimport" Tirane transferohet nga Ministria e Ekonomise Publike e Privatizimit tek "2K Group" Sh.p.k. perfaqesuar nga Z.Koço Kokedhima, ne perputhje me objektin e kesaj kontrate.

Neni 5 - Te drejtat dhe detyrimet e bleresit

- 5.1. Bleresi ka pranuar blerjen e paketes shteterore prej 51 % te aksioneve te Sh.A. "Arteksportimport" Tirane sipas proces-verbalit te zhvillimit te ankandit dhe akt

- marrevshjes se nenshkruar per kushtet e privatizimit te paketes se aksioneve date 12.10.1999 zhvilluar ne Agjencine Kombetare te Privatizimit.
- 5.2 Bleresi fiton te drejten e pronesise mbi paketen prej 51 % te aksioneve te blera prej tij pas firmosjes se kesaj kontrate ne perputhje me legjislacionin perkates.
 - 5.3. Bleresi eshte pergjegjes per te mbuluar te gjitha shpenzimet ligjore dhe te noterise ne lidhje me rregjistrimin e kesaj shitjeje. Bleresi eshte pergjegjes per transferimin e titullit te pronesise ne emer te vet.
 - 5.4. Pas nenshkrimt te kesaj kontrate, brenda 30-diteve, ne baze te ligjit Nr. 7843, date 13.07.1994 "Per rregjistrimin e pasurive te paluajtshme", pala blerese eshte e detyruar te paraqitet ne Zyren e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme te Rrethit Korçe.

Neni 6 -Te drejtat dhe detvrimet e shitesit.

- 6.1. Pala shitesese garanton bleresin per pronesine e plote dhe te ligjshme te shtetit mbi paketen prej 51 % te aksioneve te SH.A. "Arteksportimport " Tirane, te ofruara per blerje pales blerese.
- 6.2. Pala shitesese garanton bleresin per perputhjen e kesaj kontrate me frymen e legjislacionit civil ne Republiken e Shqiperise si dhe te drejtat ligjore te bleresit ne lidhje me pronesine mbi kete objekt kontrate perballe organeve gjyqesore ne rast kontestimi te kontrates , kur kjo kerkohet

Neni 7 -Baza ligjore per lidhjen e kontrates

1. Kodi Civil i Republikes se Shqiperise;
2. Ligji Nr. 7512, date 10.08.1991;
3. Ligji Nr. 7638, date 19.11.1992;
4. Ligji Nr. 8334, date 23.04.1998
5. VKM.Nr.446, date 09.07.1998,
6. VKM Nr. 405, date 31.08.1999;
7. VKM Nr. 407, date 31.08.1999;
8. Udhezimi Nr. 3, date 01.10.1999;
9. Aktmarrveshja nenshkruar midis paleve ditën e zhvillimit te ankandit date 12.10.1999.
10. Urdheri i Ministrit te Ekonomise Publike e Privatizimit Nr. 323, date 07.09.1999.

Neni 8 - Dokumentat ligjore qe i bashkengjiten kesaj kontrate

- 8.1.Urdheri i Ministrit te Ekonomise Publike e Privatizimit, Nr. 323, date 07.09.1999, per privatizimin e paketes prej 51% te SH.A "Industrialimpeks " Tirane me dy flete fotokopje e noteruar.
- 8.2.Autorizimi Nr.2884 Prot., date 12.10.1999, per kryerjen e pageses se vleres se plote te paketes se aksioneve prej 51 % te SH.A.. "Arteksportimport" Tirane leshuar nga Agjencia Kombetare e Privatizimit.

- 8.3. Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit derguar Agjencise Kombetare te Privatizimit me Nr.7145 Prot., 08.11.1999 me kater flete fotokopje e noteluar.
- 8.4. Akt-marveshje date 12.10.1999 nenshkruar midis paleve ne kete kontrate ditën e zhvillimit te ankandit me nje flete fotokopje e noteluar.
- 8.5. Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit Nr.71451 Prot., date 11.11.1999.

Neni 9 – Te ndrvshme

- 9.1. Kjo kontrate iu lexua gojarisht paleve. Kjo kontrate, me kerkesen e paleve perpilohet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe me nga 4 faqe prej te cilave nje kopje qendron ne Zyren e Noteres, nje kopje ne arshiven e Agjensise Kombetare te Privatizimit dhe dy kopje i jepen pales blerese.
- 9.2. Pala shitesë pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te tij te lire e te plote po keshtu pala blerese pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te tij te lire e te plote. Ne kete moment palet e nenshkruan kontraten ne pranine e noterit pa asnje pretendim. Une noterja, ne baze te Ligjit Nr. 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine" si dhe legjislacionit perkates per shitjen e paketes se aksioneve te zoteruara nga shteti ne shoqerite anonime e vertetoj ate sipas ligjit.

PALET KONTRAKTUESE

PALA SHITese

QIRJAKO THEODHORI
Qirjako Theodhori
 DREJTOR I PERGJITHSHEM I AKP



PALA BLERESE

"2K GROUP" Sh.P.K.



PERFAQESUAR NGA
 Z. KOCO KOKEDHIMA

NOTER



100000
100000



REPUBLIKA SHQIPERISE
 DOKUMENTA E NOTEREVE TIRANE
 689, Psh Dt 16.11.87
 VERTELIM
 vertetohet se fjalencela eshte e
 njete me origjinale. Dokumenti
 u paraft
 Nr Pasa *Z. Kokedhima*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

DEGA VENDORE TIRANË

**NOTER MAJLINDA DEMOLLARI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR.5, RR. VASO PASHA, GODINA NR.
1, APARTAMENTI NR.3, HYRJA
NR .10
TEL: 0682061560**

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

Nr. repertori: 2417

Nr. koleksioni: 930

Tirane më 01/05/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 15 fletë



A2020053790035867117

REPUBLIKA E SHQIPËRSË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
NR. 247 REP.
NR. 930 KOL.



KONTRATË SHIT-BLERJE
(AKSIONE)

Sot, më datë 01/05/2020, në Tiranë, në Zyrën e Noterisë, përpara meje Noteres publike Majlinda Demollari, me zyrë Noteriale në Rrugën: "Vaso Pasha", u paraqitën palët e mëposhtme për lidhjen e kësaj kontratë shitje:

SHITËSI: Shoqëria "2K Group" sh.p.k., regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS J82221005L, me seli në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Pallati 18, Kati II, Tiranë, përfaqësuar nga **Administratorja Znj. Brixhilda Kokëdhima**, atësia Dilaver, lindur më 10.01.1964, në Cerrik, Elbasan dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr. 028976587 dhe nr. personal G45110194N;

BLERËSI: Era **KOKËDHIMA**, e bija e Koço-s, lindur në Fier, më 14.12.1992, dhe banuese në adresën: Rr. Ismail Qemali, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me pasaportën me nr. Personal J26214046O.

DEKLARATA PARAPRAKE

- A- Shoqëria "Art Eksport Import" sha është shoqëri aksionare, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS: J61828016G.
- B- Shitësi deklaron se zotëron 48.297 (dyzetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) aksione, të kapitalit të shoqërisë "Art Eksport Import" sha, me vlerë nominale 1.000 (një mijë) Lekë, që përbëjnë 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të shoqërisë.
- C- Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit, dhe Blerësi dëshiron të blejë 48.297 (dyzetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) aksionet, që Shitësi zotëron në shoqëri, të cilat përfaqësojnë 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të shoqërisë "Art Eksport Import" sha.
- D- Në përputhje me statutin e shoqërisë "Art Eksport Import" sha, nenin 117 "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të aksioneve", pika "b" të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, nenin 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, hartohet kontrata e shitjes së aksioneve me parashikimet si më poshtë vijon:

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Shitja dhe Blerja e Aksioneve

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate, Shitësi i kalon Blerësit titullin e pronësisë mbi 48.297 (dyzetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) aksione, të cilat përfaqësojnë 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të shoqërisë "Art Eksport Import"sha.
Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet në fjalë, ndjekin këto aksione dhe kalojnë gjithashtu në favor të Blerësit.

Kalimi i Pronësisë së Ligjshme mbi Aksionet

- 1.2 Blerësi do të bëhet zotërues me të drejta të plota i aksioneve të blera në kapitalin e shoqërisë "Art Eksport Import"sha, menjëherë, me nënshkrimin e kësaj kontrate nga të dyja palët.

NENI 2

ÇMIMI DHE PAGESA

- 2.1 Çmimi i shitjes që Blerësi do t'i paguajë Shitësit për shitjen e aksioneve është 40.200.000 (dyzet milion e dyqind mijë) Lekë, çmim, i cili do të paguhet nga Blerësi në një nga mënyrat e njohura nga ligji.

NENI 3

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHITËSIT

Shitësi deklaron dhe garanton se:

- 3.1 Shitësi është pronar i vetëm dhe i ligjshëm i aksioneve që transferon tek Blerësi, dhe ka të drejtë të lidhë këtë kontratë shitblerje aksionesh si dhe të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej saj.
- 3.2 Shitësi garanton Blerësin nga çdo pretendim që të tretët mund të kenë në lidhje me aksionet, objekt të kësaj kontrate.

NENI 4


TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BLERËSIT

- 4.1 Blerësi garanton se ka të drejtë të lidhë këtë kontratë shitblerje të aksioneve dhe të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej saj.

NENI 5

TË NDRYSHME

- 5.1 Pavlefshmëria: Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj kontrate. Kushti i pavlefshëm në këtë rast,



do të zëvendësohet me një të vlefshëm, i cili do të jetë në funksion të qëllimit të palëve për lidhjen e kontratës.

- 5.2 Ligji i zbatuar: Kjo Kontratë bazohet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.
- 5.3 Mosmarrëveshjet: Çdo mosmarrëveshje që mund dhe/ose rrjedh nga interpretimi, zbatimi, kryerja, shkelja ose përfundimi i kësaj Kontrate, do të zgjidhet nga Gjykata kompetente.
- 5.4 Gjuha e kontratës: Kjo Kontratë do të nënshkruhet dhe noterizohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.
- 5.5 Kësaj Kontrate i bashkëlidhen dokumentat e listuara më poshtë, të cilat janë pjesë përbërëse e saj:
- Vendimi nr.4, datë 29.04.2020 i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “2K Group” shpk;
 - Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e shoqërisë “Art Eksport Import”sha;
 - Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e shoqërisë “2K Group”shpk;
 - Mjetet e identifikimit të palëve.

Unë Noterja pasi u’a lexova me zë të lartë Palëve të pranishme këtë Kontratë, u binda se Palët e konsiderojnë këtë Kontratë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe unë vërtetoj nënshkrimin e tyre dhe këtë akt në përputhje me ligjin.

PALËT

SHITËSI

Shoqëria “2K Group”shpk
Administratore
Znj. Brixhilda KOKËDHIMA

Brixhilda Kokëdhima



BLERËSI

Znj. Era KOKËDHIMA

Era Kokëdhima




NOTERE

NOTERE
Majlinda E. Demollari
NIP: 241605040A
Tel: 0682261550



Group

SHOQËRIA "2K GROUP" SHPK

NUIS: J82221005L

VENDIM NR.4

DATË 29/04/2020

I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË "2K GROUP" SHPK

Sot, më datë 29/04/2020, ora 10:00, në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Pallati nr.18, Kati II, Tiranë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "2K Group" shpk, për të vendosur në lidhje me rendin e ditës si më poshtë vijon:

- 1- Miratimi i shitblerjes së aksioneve të zotëruara nga shoqëria "2K Group" shpk, të cilat përbëjnë 51% të kapitalit të shoqërisë "Art Eksport Import" sha, në favor të znj. Era Kokëdhima në cilësinë e palës Blerëse, me vlerë 40.200.000 (dyzet milion e dyqind mijë) Lekë, pronësia e të cilit vërtetohet nga Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
- 2- Autorizimin e Administratores së shoqërisë "2K Group" shpk, Znj. Brixhilda Kokëdhima, për nënshkrimin e Kontratës së Shitblerjes së aksioneve;
- 3- Të ndryshme.

Në këtë mbledhje janë të pranishëm personalisht ortakët e shoqërisë dhe konkretisht:

- Znj. Brixhilda Kokëdhima, e cila zotëron 35.00% të kuotave të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Koço Kokëdhima, i cili zotëron 65.00% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Z. Koço Kokëdhima në cilësinë e Kryetarit të mbledhjes, e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve të hapur dhe të mbledhur rregullisht. Pas shqyrtimit me vëmendje të çështjeve të rendit të ditës, ortakët ranë dakord për sa më sipër dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, unanimisht,

VENDOSËN:

- 1- Miratimin e shitblerjes së aksioneve të zotëruara nga shoqëria "2K Group" shpk, të cilat përbëjnë 51% të kapitalit të shoqërisë "Art Eksport Import" sha, në favor të znj. Era Kokëdhima në cilësinë e palës Blerëse, me vlerë 40.200.000 (dyzet milion e dyqind mijë) Lekë, pronësia e të cilit vërtetohet nga Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
- 2- Autorizimin e Administratores së shoqërisë "2K Group" shpk, Znj. Brixhilda Kokëdhima, për nënshkrimin e Kontratës së Shitblerjes së aksioneve.

Pasi nuk pati çështje të tjera për të diskutuar, Kryetari i mbledhjes e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE
SHOQËRIA "2K GROUP" SHPK**

1. Znj. Brixhilda KOKËDHIMA

2. Z. Koço KOKËDHIMA



[Signature]
Brixhilda Kokëdhima

[Signature]
[Signature]





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	J82221005L
2. Data e Regjistrimit	24/09/1998
3. Emri i Subjektit	2K GROUP
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	22/06/1998
6. Kohëzgjatja	Nga: 22/06/1998
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE ISMAIL QEMALI PLL.ABISSNET K.2
8. Kapitali	30.000.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	30.000,00
9. Objekti i aktivitetit	Ushtrimi i veprimtarisë private në fushën e studimit, projektimit, supervizionin dhe ndërtimin e veprave publike dhe ndërtime të tjera, objektet turistike. Realizimin e studimeve urbane, të gjitha llojet e restaurimeve në përgjithësi, rikonstruksionet e veprave të artit, montimet e prodhimet e konstruksioneve metalike, beton armeje, plastike, të drurit dhe kombinime të ndryshme të tyre, prodhimin dhe tregjetimin e materialeve të ndërtimit, inerteve të asfaltobetonit, studim, projekttime, mbikqyrje dhe menaxhimin në fushën e shfrytëzimit të mineraleve në fushën e metalurgjisë dhe mbrojtjen e mjedisit, trajtimin e mbetjeve teknologjike, industriale, toksike dhe radioaktive, trajtimi i ujrave industriale, prodhimin e bojrave dhe llakeve të ndryshme, të ambalazheve, çdo operacion industrial prodhues, prodhimin e vajrave të ndryshme, ushqimore dhe jo ushqimore, studime, projekttime, mbikqyrje në fushën e kërkimit dhe shfrytëzimit të lëndës drusore, trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve, riaftësimin dhe trajtimin e tokave të kripura e kënetave, riparimin dhe remontet e mesme dhe të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

kapitaleve të makinave elektrike rrotulluese të cdo tipi fuqie dhe tensioni, prodhimin e motorrave dhe transformatoreve elektrike, reaktoreve të cdo tipi dhe të gjitha pajisjeve elektrike, studime dhe projektme për pajisje dhe makineri elektrike deri në prodhimin e tyre, transformatorët e tensionit të lartë, furrave elektrike, transportin urban dhe interurban të punonjësve dhe udhëtarëve, servis për tipet e ndryshme të automjeteve, konsulencë teknike në fusha të ndryshme, supervision, menaxhime dhe studime të të gjitha llojeve, realizimin e kontratave, marreveshjeve, ortakërive, shoqërive të përbashkëta apo forma të tjera, veprimtari komisionere, konsulencë në fusha të ndryshme, përfaqesime, tregtim dhe import-eksportin e mallrave të ndryshëm, industriale, ushqimore, mjekësore e të materialeve të ndërtimit, të aparaturave të mediave, të import-eksportit të mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit, të makinerive, të lëndës drusore, të lëndëve të para kimike, biokimike, të përpunuara dhe gjysëm të përpunuara, për procesin e prodhimit, tregtimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, shitblerjen e tokës, tregtimin e mallrave të gatshëm dhe gjysëm të gatshëm, botime të gazetave, të revistave, posterave, reklamave dhe botimeve të tjera, shitje shërbimesh që lidhen me këtë aktivitet, realizimin e impianteve të telekomunikacionit dhe shërbimeve të ndërlidhjes në internet, konsulencia në lidhje me to, administrimi, vendosja e përdorimi i impianteve fikse dhe të lëvizshme, për transmetime radiotelevizive, drejtimi i televizionit dhe radios, konsulencia, revizion, ekspertizë, vlerësime të kapitaleve dhe planbizneseve, projekteve të zhvillimit dhe të studimeve dhe përcaktimin e prioriteteve në fusha të ndryshme të ekonomisë, kryerjen e testeve, provave dhe matjeve laboratorike, ngritjen e laboratoreve dhe lëshimin e certifikatave për materialet e ndërtimit, rrugët, makinat elektrike, përzierjet kimike, nivelit të ndotjes së ambientit, karburantet, produktet ushqimore dhe jo ushqimore, përbërjen e shtresave të tokës dhe mineralet, nivelit të zhurmave në qendrat e banuara e industriale, vajrat izoluese dhe lubrifikante, bojrat dhe llaket, gjendjet dhe luhatjet sizmike lokale dhe rajonale etj. Administrimi i fondeve të investimeve dhe ndërmarrjeve, shoqërive, transaksione në fusha të ndryshme si dhe kryerjen e cdo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	operacioni ekonomik e juridik industrial, prodhues , tregëtar dhe financiar që lidhet , drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së shoqërisë. Investim me pjesëmarrje, blerje, shitje, në kuota, aksione dhe tituj të tjerë në shoqëritë tregtare. Kryerjen e çdo operacioni tregëtar dhe financiar që ka të bëjë me shitjen dhe blerjen e objekteve të artit si : skulptura, piktura, skica, ikona, fotografi, videoart, objekte antike si : mobilje, libra llambadare, abazhure etj.Përfaqësim ligjor dhe gjyqësor, hartimin e dokumentacionit ligjor në lidhje me përfaqësimet ligjore dhe gjyqësore, përgatitja e kërkesë padive ose kërkesave gjatë procedimit gjyqësor, si dhe e kërkesave ankimore, rekurseve kundër vendimeve gjyqësore të të gjitha shkallëve të Gjyqësorit, përgatitja e kërkesave drejtuar Gjykatës së Apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatave Ndërkombëtare dhe çdo organizmi në të cilin aderon Republika e Shqipërisë, përgatitja e ankesave dhe kërkesave të personave fizik ose juridik, përpilimi i akteve që i nënshtrohen veprimeve noteriale, hartimi i kontratave e marrëveshjeve, si dhe i çdo dokumenti tjetër që sjell ose synon të sjellë pasoja juridike, përfaqësimi i personave fizik ose juridik në çështjet civile dhe administrative, në Gjykatë, në Arbitrazh dhe në organe të tjera të administratës publike, veprime të tjera ndihmëse juridike që parashikohen në ligj	
10. Administratori/ët	Brixhilda Kokëdhima	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 22/12/2018	Deri: 22/12/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka)	Jaupaj-G	
12.1 Afati i emërimit	Nga: 22/06/2015	Deri:
13. Ortakët	BrixhildaKokëdhima	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 10.500.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	10.500,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	35,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuota zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
13.4 Komente (nëse ka)		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

14. Ortakët	KoçoKokëdhima	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 19.500.000,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	19.500,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	65,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
14.4 Komente (nëse ka)		
15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: 2 K GROUP E-Mail: herjetadeli@yaho.com Telefon: 044316655 Të Tjera: Me ceshtje nr.cn-411086-06-10 me vendim nr.1 te dates 28.05.2010, emerohet Ekspert Kontabel Z.Gëzim Jaupaj me license nr.112, per auditimin e pasqyrave financiare per vitin 2009.	
17. Statusi:	Aktiv	

Datë: 01/05/2020

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga Qendra
Kombëtare e Biznesit
Date: 2020/05/01 10:11:50 +02'00'
J82221005L20200501101133622006



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI AKSIONARE”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	J61828016G			
2. Data e Regjistrimit	30/01/1989			
3. Emri i Subjektit	ART EKSPORT IMPORT			
4. Forma ligjore	Shoqëri Aksionare			
5. Data e themelimit	23/02/1999			
6. Kohëzgjatja	Nga: 23/02/1999 Deri:			
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE 5 MAJI ISH KIMIKE			
8. Kapitali	94.700.000,000			
9. Vlera e kapitalit të shlyer:	94700000.0000			
10. Numri i aksioneve:	94.700,000			
10.1 Vlera nominale:	1.000,000			
11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë	të zakonshme	me përparësi	me të drejte vote	pa të drejte vote
11.1 Numri për secilën kategori				
12. Objekti i aktivitetit:	Importimi dhe shitja e artikujve të ndryshëm ushqimore, industriale, bujqesore, elektrike, elektronike, elektroshtepiake, konfeksione etj. Tregtimi dhe shitja e artikujve të ndryshëm ushqimore, industriale, bujqesore, elektrike, elektroshtepiake, konfeksione etj. Transporti nepermjet rrugeve tokesore, detare dhe			



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	ajrore, etj, i mallrave te siperpermendur per llogari te vete shoqerise si dhe shoqerive dhe personave te tjere juridike private dhe shteterore; Sherbime komisionere per te gjitha operacionet tregtare qe do te zhvillohen brenda dhe jashte vendit ne emer dhe per llogari te vete shoqerise si edhe te shoqerive dhe personave te tjere juridike private dhe shteterore brenda dhe jashte vendit; Kryerja e rolit te agjentit dhe magazines doganore, perfaqesuesit dhe distributorit (shperndaresit) te autorizuar ose ekskluziv sipas rastit. Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi do te kryeje cdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e saj. Kjo perfshin : hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqerive te reja si dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera brenda dhe jashte vendit.	
13. Sistemi i administrimit	<input type="checkbox"/> me një nivel <input checked="" type="checkbox"/> me dy nivele	
14. Administratori/ët	Magdaleni Kokëdhima	
14.1 Afati i emërimit	Nga: 27/04/2015	Deri: 28/03/2022
15. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
15.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka).		
16. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	Vjoalba Bengu	
16.1 Kryetar/anëtar	Anetar	
16.2 Afati i emërimit	Nga: 27/03/2019	Deri: 27/03/2022
17. Anëtar i Pavarur	Jo	
17.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	Jo	
17.2 Kushtet e pjesëmarrjes		
18. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
19. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	Merita Shaqelli	
19.1 Kryetar/anëtar	Anetar	
19.2 Afati i emërimit	Nga: 27/03/2019	Deri: 27/03/2022
20. Anëtar i Pavarur	Jo	
20.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	Jo	
20.2 Kushtet e pjesëmarrjes		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

21. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.	
22. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	Vjola Cekaj
22.1 Kryetar/anëtar	Anetar
22.2 Afati i emërimit	Nga: 27/03/2019 Deri: 27/03/2022
23. Anëtar i Pavarur	Jo
23.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	Jo
23.2 Kushtet e pjesëmarrjes	
24. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.	
25. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar	Jaupaj-G
25.1 Afati i emërimit	Nga: 10/02/2015 Deri:
26. Aksionarët	Ministria e Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes
26.1 Numri i Aksioneve	Me te drejte vote: 46403.0000 Pa te drejte vote:
26.2 Përqindja e pjesëmarrjes	49,000
27. Aksionarët	2K GROUP
27.1 Numri i Aksioneve	Me te drejte vote: 48297.0000 Pa te drejte vote:
27.2 Përqindja e pjesëmarrjes	51,000
28. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
29. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: ART EKSPORT IMPORT E-Mail: vjoalba.bengu@abissnet.al Telefon: 2256021 Të Tjera: Me depozitim të vendimit nr.1 date 01.05.2009 behen ndryshimet e meposhtme: Z.Andi Derhemi emerohet kryetar i Keshillit Mbikqyres dhe.Z.Erardi Daberdaku emerohet nenkryetar i Keshillit Mbikqyres.Publikimi i kerkeses per doreheqje nga detyra e administratorit te shoqerise te Z.Koço Kokedhima date 15.12.2009 si dhe vendimin nr.4 date 31.12.2009 te keshillit mbikqyres.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

30. Statusi:	Pezulluar

Datë: 01/05/2020

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga Qendra
Kombëtare e Biznesit
Date: 2020/05/01 10:13:02 +02'00'
J61828016G20200501101246202006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)